



KUSHTET ADMINISTRATIVE DHE TEKNIKE AUTORIZIMI I QENDRAVE PËR CERTIFIKIMIN E PAJISJEVE ELEKTRONIKE FISKALE

Datë: 10.12.2018

Bazuar në nenin 14 të Udhëzimit Administrativ MF-Nr.02/2018 për Shfrytëzimin e Pajisjeve Elektronike dhe Sistemeve Fiskale, përcaktohen kriteret si në vijim:

- 1) Subjekti që aplikon për QCPEF duhet të jetë:
 - a) Institucion Edukativ i Arsimit të lartë i akredituar nga MASHT ose
 - b) Operator Ekonomik, i regjistruar në MTI për veprimtari se paku në njërin nga fushat: kompjuterike, elektroteknike dhe shkencat matematikë/informatikë.
- 2) Subjekti duhet ta emëroj / formoj grupin punues i cili do të funksionoj si QCPEF. Në krye të grupit punues duhet të emërohet një kuadër me gradë shkencore, së paku MSc së paku në njërin nga fushat e përshkruara në pikën 1)
- 3) Subjekti duhet të ketë pajisje të nevojshme për kontrollimin dhe testimin e Pajisjeve Elektronike Fiskale me ndihmën e të cilave me përgjegjësi të plotë do të vërtetohet funksionalitetin ose eventualisht mos-funksionalitetin e Pajisjeve Fiskale, duke u bazuar në dokumentin “Pajisjet Elektronike Fiskale kërkesat, karakteristikat funksionale dhe teknike” dhe atë:
 - a) Pajisje matëse për matje të: fushave elektrike, elektromagnetike si dhe parametrat tjerë themelorë të pajisjeve elektrike;
 - b) Pajisje për testime dhe verifikim të njësisve matëse elektronike analoge dhe digjitale;
 - c) Pajisje të sofistikuar për leximin e ROM, PROM, EEPROM memorieve si dhe medime tjera të natyrës së ngjashme;
 - d) Pajisje për testime të sistemeve me mikroprocesorë dhe mikro kontrollorë.

Dokumentacioni që duhet të dorëzohet për aplikim

- 1) Dëshmia për akreditim (e detyrueshme për Institucionet Edukative Arsimore) ose Certifikata për regjistrim nga MTI (për operatorët ekonomik);
- 2) CV për udhëheqësin QCPEF;
- 3) Deklarata me shkrim për formimin e grupit punues i cili do të merret me testimin dhe certifikimin e Pajisjeve Elektronike Fiskale, e nënshkruar nga udhëheqësi i QCPEF;
- 4) Dokumentacionin lidhur me posedimin e pajisjeve të punës për këtë qëllim, të përshkruara në pikën 3 (a, b, c, d) të këtij dokumenti.

Çmimet e shërbimeve qe kryhet nga QCPEF

Çdo Operator Ekonomike qe është para-licencuar për projektin e arkave fiskale duhet t'i bëjë pagesën Qendrës për Certifikimin e Pajisjeve Elektronike Fiskale (QCPEF), si me poshtë:

1. Për testim te parë për një model te pajisjes çmimi maksimal mund të jetë 2,000 €
2. Për testim për herën e dytë te të njëjtit model te pajisjes çmimi maksimal mund të jetë 1,000 €

Për çdo informatë dhe pyetje në lidhje me këtë proces ju lutem kontaktoni në adresat si me poshtë:

Komisioni për Autorizim të Operatorëve Ekonomik

Tel : +381 38 200 251 02

Fax : + 381 200 250 07

e-mail : KAOE@atk-ks.org